



Ambasada e Republikës së Çekisë në Prishtinë

Mundësi studimi në Republikën Çeke

Çdo vit, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Çekisë ofron bursa që të përkrah studentët e huaj në Universitetet Publike të Çekisë. Për më tepër, universitetet çeke dhe shkollat e larta ofrojnë një shumëllojshmëri të gjerë të programeve të cilësisë së lartë dhe kurse trajnimi që mbulojnë shumë fusha të dijes dhe ekspertizes, në anglisht.

Pse të studiojmë në Republikën Çeke?

Arsimi i lartë në Republikën Çeke gëzon një reputacion të botës së gjërë për cilësinë e saj të lartë. Kjo cilësi është mbrojtur nga një sistem kombëtar i rregullimit dhe sigurimit të cilësisë. Theksi në arsim është i kuptueshëm sepse gjithmonë ka luajtur një rol kyç në jetën e popullit çek. Në vitin 1348, në Pragë kur u themelua Universiteti i parë në Evropën Qendrore (nga Mbreti çek, Çarlsi IV). Trajnimi dhe hulumtimi ishin vendimtarë për një zhvillim të ri të kombit në historinë e saj moderne. Republika Çeke, një vend i vogël në zemër të Evropës, është shumë e vetëdijshme që një bashkëpunim në shkencë dhe inovacion është një sukses afatgjatë në botën e globalizuar.

Studimi në Republikën Çeke, në një vend të kryqëzimeve kulturore, është i përshtatshëm për të ndihmuar në zhvillimin e një mendjeje të hapur dhe të forcojë aftësinë e çdo studenti për të punuar së bashku me popuj tjerë të prejardhjeve të ndryshme. Po ashtu, mund të shërbejë si një qendër për adaptim të mëtejshëm në mjedis modern arsimor në dy nivele evropiane dhe globale. Standardet e jetesës në Republikën e Çekisë janë mjaft të larta përderisa shpenzimet e jetesës mbesin të arsyeshme.

Çdo vit, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Çekisë ofron bursa qeveritare nën bashkëpunimin e zhvillimit të huaj për përkrahjen e studentëve të huaj në universitetet publike çeke.

Për më shumë, universitetet çeke dhe shkollat e larta ofrojnë një shumëllojshmëri të gjerë të programeve të cilësisë së lartë dhe kurse trajnimi që mbulojnë shumë fusha të dijes dhe ekspertizes, në anglisht.

Çdo shkollë publikon informata të detajuara rreth fushës së studimit në faqen e tyre të internetit. (shih më poshtë).

Për vitin akademik 2012/2013, do të jenë dy bursa qeveritare në dispozicion për studentët nga Republika e Kosovës, për programet e studimit Master në **fushën e ekonomisë, informatikës dhe bujqësisë**. Për informata më të detajuara, format e aplikimit dhe të gjitha kërkesat, ju lutem vizitoni pjesën përkatëse të faqes së internetit të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në Ambasadën e Republikës Çeke në Prishtinë nga **31 Dhjetori 2011**.

Faza e parë e procedurës së përzgjedhjes – testi në gjuhën Angleze - do të mbahet në ambientet e Ambasadës Çeke më **10 Janar 2012**.

Për informata të mëtejme kontrolloni faqet vijuese të internetit.

- Informata të përgjithshme rreth studimit në Republikën Çeke me një list të institucioneve të larta arsimore dhe mundësive të bursave: www.studyin.cz
- Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit: www.msmt.cz
- Qendra e informacionit dhe e njohjes kombëtare akademike çeke: www.naric.cz
- Bursat: <http://www.msmt.cz/international-cooperation-1/scholarships>
- Linqe të tjera të dobishme : www.czech.cz, www.dzs.cz

Për më tepër informata ju lutem kontaktoni Behar Zogiani, në këtë adresë : bzogiani@yahoo.com; tel: + 381 38 246 676